



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Njoftim publik Nr. 05 Nr. 015/02-32185/25


Komuna e Prishtinës, ka filluar procedurën me numër 05-015/02-32185/25 dt. 04.03.2025, në emër të aplikuesit “Prime Group Construction” shpk, përmes së cilës kërkohet të emërtohen rrugët dhe të caktohet adresa për ndërtimin e kompleksit afarist – banesorë “Prime City 07”. Agjencia Kadastrale e Kosovës e ka digjitalizuar (si rrugë të re) segmentin e rrugës që shtrihet në këtë hapësirë, ndërsa Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës duke u bazuar në Neni 2, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Vendimin 01 nr. 031 -223419 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Neni 6, pika 1.2., pika 1.2.1.2., Neni 7, pika 1, pika 2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH – së, i ka dhënë kësaj rruge të re një kod të veçantë (12929) si dhe ka bërë propozimin për emërtimin e kësaj rruge.

Emri i propozuar: **GANI XHAFOLLI** – (1945- 2015) Shkrimtar,
GJON SIMONI (1936 – 1999) – Kompozitor,
BEDRI MALOKU (1956 – 1999) – Dëshmor.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 21.05.2025 deri më 30.05.2025, në E-mail adresën: urbanizmpirishtine@rks-gov.net

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2019 të MMPH –së, për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal, neni 7, paragrafët 1 dhe 2, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në web-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në web-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë si dhe kodi i rrugës përkatëse.



Nënshkrimi i Zyrtarit: